



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 9 gusht 2021
Nr. ref.:RK 1823/21

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI14/21

Parashtrues

Shpejtim Hajrizi

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme,
PML.nr.335/2020 të 23 dhjetorit 2020**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSVËS

Arta Rama-Hajrizi, kryetare,
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar,
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare,
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare,
Safet Hoxha, gjyqtar,
Radomir Laban, gjyqtar,
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare, dhe
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është parashtruar nga Shpejtim Hajrizi (në tekstin e mëtejme: parashtruesi i kërkesës) me vendbanim në Baballoq, të komunës së Deçanit.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës konteston Aktgjykimin e Gjykatës Supreme, PML nr.335/2020, të 23 dhjetorit, 2020, në ndërlidhje me Aktgjykimin e Gjykatës së Apelit PA1.nr.300/2020 të 22 qershorit 2020 dhe Aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Mitrovicë Pn.nr.978/2019 të 21 janarit 2020.
3. Aktgjykimi i kontestuar i është dorëzuar parashtruesit të kërkesës me 5 janar 2021.

Objekti i çështjes

4. Objekt i çështjes së kërkesës është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të kontestuar, me të cilin parashtruesi i kërkesës pretendon shkeljen e të drejtave të tij të garantuara me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta), në lidhje me nenin 6 [E drejta për një proces të rregullt] të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejme: KEDNJ).

Baza juridike

5. Kërkesa bazohet në paragrafin 1 dhe 7, të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, nenet 22 [Procedimi i kërkesës] dhe 47 [Kërkesa individuale] të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe rregullin 32 [Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve] të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

6. Më 19 janar 2021, parashtruesi i kërkesës e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
7. Më 25 janar 2021, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtarin Nexhmi Rexhepi gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Arta Rama-Hajrizi (kryesuese), Gresa Caka-Nimani dhe Safet Hoxha (anëtarë).
8. Më 29 janar 2021, Gjykata njoftoi parashtruesin e kërkesës për regjistrimin e kërkesës dhe kërkoi nga i njëjti plotësimi e formularit të kërkesës dhe dorëzimin e dokumentacionit të nevojshëm. Të njëjtën ditë një kopje e kërkesës në pajtim me Ligjin iu dërgua Gjykatës Supreme.
9. Më 18 shkurt 2021, parashtruesi i kërkesës ka plotësuar formularin e kërkesës dhe ka dorëzuar dokumentacionin mbështetës, sipas kërkesës së gjykatës të 29 janarit 2021.
10. Më 17 maj 2021, bazuar në paragrafin 5 të nenit 114 [Përbërja dhe Mandati i Gjykatës Kushtetuese] të Kushtetutës dhe Rregullit 12 (Zgjedhja e Kryetarit dhe e Zëvendëskryetarit) të Rregullores së punës, gjyqtarja Gresa Caka-Nimani u zgjodh Kryetare e Gjykatës Kushtetuese. Bazuar në paragrafin (4) të rregullit 12 të Rregullores së punës dhe Vendimit të Gjykatës KK-SP.71-2/21, u përcaktua që

gjyqtarja Gresa Caka-Nimani, detyrën e Kryetares së Gjykatës e merr pas përfundimit të mandatit të Kryetares aktuale të Gjykatës, Arta Rama-Hajrizi, më 26 qershor 2021.

11. Më 26 qershor 2021, bazuar në paragrafin (4) të rregullit 12 të Rregullores së punës dhe Vendimit të Gjykatës KK-SP.71-2/21, gjyqtarja Gresa Caka-Nimani mori detyrën e Kryetares së Gjykatës, ndërsa bazuar në pikën 1.1 të paragrafit 1 të nenit 8 (Përfundimi i mandatit) të Ligjit, Kryetarja Arta Rama-Hajrizi përfundoi mandatin e Kryetares dhe të gjyqtarës së Gjykatës Kushtetuese.
12. Më 28 qershor 2021, Kryetarja e Gjykatës Gresa Caka-Nimani, nxori Vendimin K.SH.KI14/21, duke e zëvendësuar Kryetaren paraprake Arta Rama-Hajrizi si kryesuese, si dhe caktoi gjyqtaren Selvete Gërxhaliu-Krasniqi si anëtare të Kolegjit shqyrtues.
13. Më 29 korrik 2021, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës në përbërje të plotë që ta deklarojë kërkesën të papranueshme si qartazi të pabazuar.

Përmbledhja e fakteve

Hyrje

14. Parashtruesi i kërkesës, me vendim gjyqësor të formës së prerë [P.nr.124/18], ishte shpallur fajtor për kryerjen e veprës penale (vjedhje e rendë) nga neni 327, paragrafi 1, nenparagrafi 1.1 i Kodit Penal të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: KPRK), për të cilën veprë është dënuar me burgim efektiv në kohëzgjatje prej 2 (dy) vitesh. Më 9 janar 2018, parashtruesi i kërkesës ishte dërguar në vuajtje të dënimit në qendrën korrektuese në Smerkovnicë. Më 1 janar 2019 parashtruesi i kërkesës së bashku me një të burgosur tjetër u arratisen nga kjo qendër korrektuese. Ndaj parashtruesit të kërkesës autoritetet kompetente iniciuan procedurat siç janë shënuar me poshtë:

Procedura gjyqësore (penale)

15. Më 6 nëntor 2019, Prokuroria Themelore në Mitrovicë, ngriti aktakuzën PP.II.nr.3660/19, kundër parashtruesit të kërkesës dhe të arratisurit tjetër për shkak të kryerjes së veprës penale (arratisje e personit të privuar nga liria) nga neni 397, paragrafi 1, lidhur me nenin 31 të KPRK-së.
16. Më 21 janar 2020, Gjykata Themelore në Mitrovicë, me Aktgjykimin P.nr.978/2019, e shpalli fajtor parashtruesin e kërkesës për shkak të kryerjes së veprës penale, “arratisje e personit të privuar nga liria” nga neni 397, paragrafi 1, lidhur me nenin 31 të KPRK-së, duke e dënuar të njëjtin me burgim efektiv, në kohëzgjatje prej 1 (një) viti.
17. Më 1 shkurt 2020, parashtruesi i kërkesës parashtroi ankesë në Gjykatën e Apelit, kundër Aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë, të 21 janarit 2020, për shkak të shkeljeve të ligjit penal, shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe vendimit në lidhje me sanksionin penal (dënimin).

18. Më 10 mars 2020, Prokurori i Apelit në Prishtinë i propozoi Gjykatës së Apelit, që ta refuzojë ankesën si të pabazuar dhe ta vërtetojë Aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë, të 1 shkurtit 2020 si të drejtë dhe të bazuar në ligj.
19. Më 22 qershor 2020, Gjykata e Apelit, nxori Aktgjykimin PA1.nr.300/2020, me të cilin aprovoi pjesërisht ankesën e mbrojtësit të parashtruesit të kërkesës dhe sipas detyrës zyrtare e ndryshoi Aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë, të 21 janarit 2020, përkitazi me vendimin për dënimin, duke e ulur masën e dënimit nga 1 (një) vit, në 6 (gjashtë) muaj. Pretendimet e tjera të parashtruesit të kërkesës për unifikimin e dënimit dhe për mbrojtje efektive u refuzuan nga kjo gjykatë si të pabazuara.
20. Më 17 nëntor 2020, parashtruesi i kërkesës parashtrroi kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë në Gjykatën Supreme, për shkak të shkeljes së ligjit penal, shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe shkeljeve të tjera të dispozitave të procedurës penale që kanë ndikuar në ligjshmërinë e vendimit gjyqësor, me propozimin që Gjykata Supreme të aprovojë si të bazuar kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë, të anulojë aktgjykimet e kundërshtuara dhe që lëndën ta kthejë në rivendosje në gjykatën e shkallës së parë. Mbrojtësi i parashtruesit të kërkesës në këtë kërkesë theksoi: *"...gjykata e shkallës së dytë ka ndryshuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë përkitazi me vendimin për dënimin në atë mënyrë që të dënuarit i ka shqiptuar dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muaj, mirëpo me këtë rast gjykata e shkallës së dytë ka qenë dashur që të dënuarit ti jep mundësinë që dënimi me burgim ti shndërrohet në dënim me gjobë apo urdhër për punë me dobi të përgjithshme, siç parashihet me dispozitat e nenit 47 dhe 48 të KPRK-së".*
21. Më 8 dhjetor 2020, Zyra e Kryeprokurorit të shtetit kërkoi që kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë e parashtruesit të kërkesës të refuzohet si e pabazuar .
22. Më 23 dhjetorit 2020, Gjykata Supreme nxori Aktgjykimin PML.nr.335/2020, me të cilin refuzoi kërkesën e parashtruesit të kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë, ushtruar kundër Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit, të 22 qershorit 2020, duke refuzuar pretendimet e parashtruesit të kërkesës lidhur me: 1) të drejtën e mbrojtjes; 2) për shndërrimin e dënimit me burg efektiv në dënim me gjobë; dhe 3) për lartësinë e dënimit, duke arsyetuar se të gjitha pretendimet në fjalë janë të pabazuara në ligj dhe instrumente ndërkombëtare.

Pretendimet e parashtruesit

23. Parashtruesi i kërkesës pretendon se me vendimet e gjykatave të rregullta i janë shkelur të drejtat e tij të garantuara me nenin 31 të Kushtetues dhe nenin 6 të KEDNj-së, përkatësisht e drejta në mbrojtje efektive në ndërlidhje me barazinë e palëve në procedurë penale, në ndërlidhje me nenin 9 të KPPRK, ku përcaktohet se *"Nëse me këtë Kod nuk parashihet ndryshe, i pandehuri dhe prokurori i shtetit në procedurë penale kanë pozitë të barabartë".*
24. Përkitazi me të drejtën për mbrojtje dhe barazi të palëve, parashtruesi i kërkesës pretendon se barazia e palëve si parim themelor i procedurës penale është pjesë integrale e gjyqimit të drejtë, sepse pozita e personit të akuzuar në procedurë penale, i cili përballet me dyshimin e kryerjes së veprës penale, dhe mundësinë

e shqiptimit të sanksioneve penale, e bën të domosdoshme nevojën e respektimit rigoroz të të drejtave dhe garancive procedurale ndaj tij. Në këtë drejtim, ka rëndësi të posaçme që i pandehuri/gjykuari të jetë i barabartë me prokurorin e shtetit i cili përfaqëson organin e akuzës, e që shprehet me parimin e barazisë së palëve në procedurë penale.

25. Parashtruesi i kërkesës thekson se sipas legjislacionit të Kosovës përkitazi me mbrojtjen në procedurë penale, përcaktohet sistemi i mbrojtjes së detyruar dhe sistemi i mbrojtjes jo të detyruar ose fakultativ. Caktimi i mbrojtësit me shpenzime publike, kur mbrojtja nuk është e detyruar rregullohet në nenin 58 të KPPRK, ku në par. 1 (nënparg. 1.1 dhe 1.2), përcaktohet se kur nuk ekzistojnë kushtet për mbrojtjen e detyruar, të pandehurit i caktohet mbrojtës me shpenzime publike me kërkesën e tij, nëse: nuk ekzistojnë kushtet për mbrojtje të detyrueshme e procedura penale zhvillohet për vepër penale për të cilën është paraparë dënimi me burgim me tetë (8) ose me shumë vjet, ose kur këtë e kërkojnë interesat e drejtësisë pavarësisht nga dënimi i parashikuar, të dyshuarit apo të pandehurit me kërkesën e tij, i caktohet mbrojtësi, në qoftë se sipas gjendjes pasurore të tij nuk mund t'i përballojë shpenzimet e mbrojtjes së tij. KPPRK nuk ka një përkufizim ose kriteret të veçanta në lidhje me interpretimin e se kur ekziston "interesi i drejtësisë" për caktimin e mbrojtësit me shpenzime publike. Andaj, në lidhje me sqarimin e këtij kriteri, Avokati i Popullit bazohet në interpretimin e dispozitave të tjera ligjore në lidhje me të drejtën e caktimit të mbrojtësit me shpenzime publike, përcaktimet e akteve ndërkombëtare dhe në veçanti standardin e ndërtuar nga jurisprudenca e GjEDNj, si burim detyrues dhe me prioritet për sistemin e drejtësisë penale në Kosovë.
26. Parashtruesi i kërkesës gjithashtu për rrethanat e rastit të tij i referohet garancive të nenit 6.3 të KEDNj-së, duke theksuar se Konventa përcakton të drejtën në mbrojtje dhe në veçanti kur është e nevojshme edhe dhënien e ndihmës juridike falas (pika c), që lidhet kryesisht me konceptin e barazisë së armëve dhe respektimin e këtij parimi. Parimit të barazisë së armëve i ka dhënë rëndësi të posaçme GjEDNj në praktikën e saj, duke theksuar qartësisht se çdokush që është palë në proces gjyqësor duhet të ketë mundësi të barabartë që të paraqesë çështjen e vet dhe se asnjë palë nuk duhet të gëzojë ndonjë avantazh të konsiderueshëm ndaj kundërshtarit. Për më tepër, gjykata për çështjet penale parimin e barazisë së armëve e ka lidhur ngushtë me lehtësirat e barabarta që mbrojtja duhet të ketë në raport me prokurorin e shtetit, duke i mundësuar shfrytëzimin e të gjitha mjeteve ligjore pa asnjë pengesë ose vonesë të paarsyeshme, përfshirë edhe moskufizimin e qasjes në faktet dhe provat që lidhen me rastin e tij apo edhe mundësinë e qasjes në dokumente publike. Gjithashtu, parimi i barazisë së armëve duhet të shprehet edhe lidhur me dëshmitarët apo ekspertët, që pavarësisht nga cila palë propozohen, ata duhet të gëzojnë të njëjtat lehtësira para gjykatës, në të kundërtën kjo paraqet shkelje të nenit 6 të KEDNj.
27. Parashtruesi tutje thekson se e drejta e të pandehurit/gjykuarit për mbrojtje efektive përcaktohet edhe me nenin 14 (3) në Paktin Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike dhe me nenin 11 (1) të Deklaratës Universiade për të drejta të Njeriut.

28. Në fund, parashtruesi i kërkesës pretendon se është shkelur rëndë parimi i ligjshmërisë, dhe se bazuar në analizën e vendimeve gjyqësore të kontestuara me këtë kërkesë, arrihet të konkluzioni se gjykatat e rregullta kanë aplikuar dispozitat ligjore përkatëse në mënyrë të gabuar ose arbitrare, të njëanshme, në dëm të parashtruesit, me çka kanë shkelur garancitë kushtetuese të mbrojtura me nenin 31 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së. Në këtë kontekst, parashtruesi i është referuar rastit të GjEDNJ-së *Talpis kundër Italisë*, ankesa nr. 41237114, GjEDNJ, Aktgjykim i 18 shtatorit 2017, paragrafi 77, ku përcaktohet se një ankesë karakterizohet nga faktet që përmban ajo dhe jo vetëm nga baza ligjore dhe argumentet e referuara shprehimisht në të nga palët.

Dispozitat relevante ligjore

Kodi Penal Nr. 04/L-082 i Republikës së Kosovës

Neni 47

Zëvendësimi i dënimit me burgim me dënim me gjobë

Kur gjykata shqipton dënimin me burgim deri në gjashtë (6) muaj, gjykata njëkohësisht mund të vendosë që dënimi me burgim të zëvendësohet me dënim me gjobë, me pëlqimin e personit të dënuar.

Kodi Nr. 04/L-123 i Procedurës Penale të Republikës së Kosovës

Neni 9

Barazia e palëve

1. Nëse me këtë Kod nuk parashihet ndryshe, i pandehuri dhe prokurori i shtetit në procedurë penale kanë pozitë të barabartë.

Neni 57

Mbrojtësi në rastet e mbrojtjes së detyruar

1. I pandehuri duhet të ketë mbrojtës në këto raste të mbrojtjes së detyruar:
 - 1.1. nga marrja në pyetje për herë të parë kur i pandehuri është memec, shurdh, i verbër ose shpreh shenja të çrregullimeve apo paaftësisë mendore dhe kështu është i paaftë që të mbrohet vetë me sukses;
 - 1.2. gjatë seancës për caktimin e paraburgimit dhe gjatë kohës derisa ai gjendet në paraburgim;
 - 1.3. nga ngritja e aktakuzës, kur aktakuza është ngritur kundër tij për vepër penale të dënueshme me të paktën dhjetë vjet burgim;
 - 1.4. në procedurë sipas mjeteve të jashtëzakonshme juridike kur i pandehuri është memec, shurdh ose shpreh shenja të çrregullimit apo të paaftësisë mendore ose është shqiptuar dënim me burgim të përjetshëm; dhe
 - 1.5. në të gjitha rastet kur i pandehuri kërkon të hyjë në marrëveshje për pranimin e fajësisë për vepër penale për të cilën parashihet dënim me së paku një (1) vit burgim, i pandehuri duhet të përfaqësohet nga mbrojtësi.
2. Në qoftë se i pandehuri në rastin e mbrojtjes së detyruar nuk angazhon mbrojtës, e angazhimin nuk e bën askush nga personat në nenin 53. paragrafi 8. i këtij Kodi, gjykata ose një organ tjetër kompetent i cakton një mbrojtës sipas detyrës zyrtare me shpenzime publike. Kur mbrojtësi caktohet sipas detyrës zyrtare pasi të jetë ngritur aktakuza, i pandehuri njoftohet për këtë me rastin e dorëzimit të aktakuzës.

3. Në qoftë se i akuzuari në rastin e mbrojtjes së detyruar mbetet pa mbrojtës gjatë procedurës dhe nëse ai nuk angazhon mbrojtës tjetër, gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues apo organi kompetent që e zbaton procedurën në fazën paraprake cakton një mbrojtës të ri sipas detyrës zyrtare në shpenzime publike.
4. Personi juridik nuk ka të drejtë në mbrojtës të caktuar me shpenzime publike.

Neni 58

Mbrojtësi me shpenzime publike, kur mbrojtja nuk është e detyruar

1. Kur nuk ekzistojnë kushtet për mbrojtjen e detyruar, të pandehurit i caktohet mbrojtës me shpenzime publike me kërkesën e tij, nëse:
 - 1.1. nuk ekzistojnë kushtet për mbrojtje të detyrueshme e procedura penale zhvillohet për vepër penale për të cilën është paraparë dënimi me burgim me tetë (8) ose më shumë vjet, ose
 - 1.2. këtë e kërkojnë interesat e drejtësisë pavarësisht nga dënimi parashikuar, të dyshuarit apo të pandehurit me kërkesën e tij i caktohet mbrojtësi, në qoftë se sipas gjendjes pasurore të tij nuk mund t'i përballojë shpenzimet e mbrojtjes së tij.
2. I pandehuri njoftohet për të drejtën e tij në mbrojtës me shpenzime publike sipas paragrafit paraprak para se të merret në pyetje për herë të parë.
3. Kërkesa për caktimin e mbrojtësit me shpenzime publike sipas paragrafit 1. të këtij neni mund të bëhet gjatë gjithë procedurës penale. Kryetari i gjykatës ose organi kompetent i cili zbaton procedurën në fazën paraprake vendos për kërkesën dhe cakton mbrojtës. Nëse policia ose prokurori i shtetit refuzon kërkesën e të pandehurit për t'i caktuar mbrojtës me shpenzime publike, i pandehuri mund t'i ankohet gjyqtarit të procedurës paraprake.
4. Para caktimit të mbrojtësit me shpenzime publike sipas këtij neni, i pandehuri duhet të plotësojë një deklaratë duke cekur pasuritë e tij dhe të deklarohet se nuk mund të përballojë shpenzimet e mbrojtësit ligjor.

Pranueshmëria e kërkesës

29. Gjykata së pari vlerëson nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara në Kushtetutë dhe të parashikuara më tej në Ligj dhe në Rregullore të punës.
30. Në këtë drejtim, Gjykata u referohet paragrafëve 1 dhe 7, të nenit 113 [Jurisdiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, në lidhje paragrafin 4, të nenit 21 [Parimet e Përgjithshme], të Kushtetutës, që përcaktojnë:

Neni 113

[Jurisdiksioni dhe Palët e Autorizuara]

"1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.

[...]

7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.”

[...]

31. Gjykata në vazhdim shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, siç përcaktohen tutje në Ligj, përkatësisht me nenet 47, 48 dhe 49 të Ligjit, që përcaktojnë:

Neni 47
[Kërkesa individuale]

*“1. Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tija individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.
2. Individ i mund ta ngritë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.”*

Neni 48
[Saktësimi i kërkesës]

“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj.”

Neni 49
[Afatet]

“Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor. Në të gjitha rastet e tjera, afati fillon të ecë në ditën kur vendimi ose akti është shpallur publikisht... .”

32. Përkitazi me përmbushjen e kriterëve të lartcekura, Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës: 1) legjitimohet si palë e autorizuar, në kuptim të nenit 113.7 të Kushtetutës; 2) i njëjti konteston kushtetutshmërinë e një akti të autoritetit publik, përkatësisht Aktgjykimin PML.nr.62/2020 të Gjykatës Supreme; 3) i ka shteruar të gjitha mjetet juridike në dispozicion, në kuptim të fjalisë së dytë të nenit 113.7 të Kushtetutës dhe paragrafit 2 të nenit 47 të Ligjit; 4) i ka specifikuar qartë të drejtat e garantuara me Kushtetutë dhe KEDNj, të cilat pretendohet se i janë shkelur, si dhe e ka specifikuar aktin e autoritetit publik kushtetutshmërinë e të cilit e konteston, në pajtim me kërkesat e nenit 48 të Ligjit; dhe 5) e ka parashtruar kërkesën brenda afatit ligjor prej katër (4) muajsh të paraparë në nenin 49 të Ligjit.
33. Megjithatë, Gjykata gjithashtu merr parasysh kërkesat e rregullit 39 [Kriteret e Pranueshmërisë], përkatësisht paragrafin (2) të Rregullores së punës, që përcakton:

Rregulli 39
[Kriteret e pranueshmërisë]

“(2) Gjykata mund ta konsiderojë kërkesën të papranueshme, nëse kërkesa është qartazi e pabazuar, sepse parashtuesi nuk dëshmon dhe nuk mbështetë në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij.”

34. Gjykata rikujton se parashtuesi i kërkesës pretendon se gjykatat e rregullta në rastin e tij shkelen të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të KEDNj-së.
35. Në lidhje me këtë rast, Gjykata vëren se parashtuesi i kërkesës në të vërtetë përsërit të njëjtat pretendime, të cilat i kishte ngritur në Gjykatën e Apelit dhe në Gjykatën Supreme. Në thelb parashtuesi i kërkesës pretendon se gjatë zhvillimit të procedurës penale pranë Gjykatës Themelore në Mitrovicë i është shkelur e drejta në mbrojtje, të cilin e ndërlidhë me barazinë e palëve në procedurë penale sipas nenit 58 të KPPRK-së.
36. Prandaj, Gjykata në vijim, pretendimet e parashtuesit të kërkesës përkitazi me të drejtën në mbrojtës do t'i elaborojë në dritën e garancive procedurale të garantuara me nenet 30 dhe 31 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 të KEDNj-së, dhe në pajtueshmëri me kërkesat e nenit 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës, sipas të cilave Gjykata është e detyruar të interpretojë të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me Kushtetutë.
37. Përkitazi me këtë, Gjykata i referohet paragrafit 5, të nenit 30 [Të Drejtat e të Akuzuarit] të Kushtetutës, që përcakton:

Nenin 30
[Të Drejtat e të Akuzuarit]

Çdokush që akuzohet për vepër penale, gëzon të drejtat minimale në vijim:
[...]
(5) të ketë ndihmën e një mbrojtësi që e zgjedh, të komunikojë lirisht me të dhe, nëse nuk ka mjete të mjaftueshme, t'i sigurohet mbrojtja falas;
[...]

38. Tutje, Gjykata rikujton përmbajtjen e paragrafit 6, të nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës dhe të paragrafit 3 (c) të nenit 6 të KEDNj-së, që përcaktojnë:

Nenin 31
[E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm]

[...]
1. Çdokujt i garantohet mbrojtje e barabarte e të drejtave në procedure para gjykatave, organeve të tjera shtetërore dhe bartësve të kompetencave publike...;
[...]

6. Ndihma juridike falas do t'u mundësohet atyre që nuk kanë mjete të mjaftueshme financiare, nëse një ndihmë e tillë është e domosdoshme për të siguruar qasjen efektive në drejtësi.
[...]

Neni 6 i KEDNj-së
[E drejta për një proces te rregullt gjyqësor]

"3. Çdo i akuzuar për një vepër penale ka të drejtat minimale të mëposhtme: (...)

c) të mbrohet vetë ose të ndihmohet nga një mbrojtës i zgjedhur prej tij ose, në qoftë se ai nuk ka mjete të mjaftueshme për të shpërblyer mbrojtësin, t'i mundësohet ndihma ligjore falas kur këtë e kërkojnë interesat e drejtësisë."

Parimet themelore mbi të drejtën në mbrojtje sipas praktikës gjyqësore të GjEDNj-së

39. GjEDNj, në praktikën e saj gjyqësore ka ritheksuar "[...] edhe pse jo absolute, e drejta e secilit, i cili është akuzuar për një vepër penale që në mënyrë efektive të mbrohet nga një avokat është një nga veçoritë themelore të gjykimit të drejtë" (shih rastet e GjEDNj-së, *Salduz kundër Turqisë* [DHM], kërkesa nr. 36391/02, Aktgjykim i 27 nëntorit 2008, paragrafi 51, *Dembukov kundër Bullgarisë*, kërkesa nr. 68020/01, Aktgjykim i 28 shkurtit 2008, paragrafi 50, *Ibrahim dhe të tjerët kundër Mbretërisë së Bashkuar* [DHM], kërkesat nr. 50541/08, 50571/08, 50573/08 dhe 40351/09, Aktgjykim i 13 shtatorit 2016, paragrafi 255).
40. Sipas, GjEDNj-së, neni 6, paragrafi 3, pika c, përmban tri të drejta të ndryshme: (i) atë për t'u mbrojtur vetë; (ii) atë për të pasur ndihmën e një mbrojtësi të zgjedhur vetë dhe (iii) të ndihmës juridike falas nga një avokat (shih rastin *Pakelli kundër Gjermanisë*, kërkesa nr. 8398/78, Aktgjykim i 25 prillit 1983, paragrafi 31).
41. Marrë për bazë kontekstin e rastit konkret, Gjykata në vijim do t'i referohet praktikës gjyqësore të GjEDNj-së përkitazi me të drejtën për t'u mbrojtur vetë dhe të drejtës për ndihmë juridike falas.
42. Përkitazi me të drejtën për tu mbrojtur vetë, praktika gjyqësore e GjEDNj-së, përcakton se, "e drejta për t'u mbrojtur vetë nuk garantohej në mënyrë absolute". Çështja nëse të akuzuarit i lejohet për t'u mbrojtur vetë apo t'i caktohet një avokat "...është në varësi të legjislacionit vendor në fuqi apo rregullave të gjykatës përkatëse." Në këtë rast, shtetet anëtare gëzojnë hapësirë për vlerësim dhe janë në pozitë më të mirë për të zgjedhur mjetin që këshillohet në kuadër të sistemit të tyre gjyqësor për të garantuar të drejtat e mbrojtjes (shih rastin *Correia de Matos kundër Portugalisë* [DHM], kërkesa nr. 56402/12, Aktgjykim i 4 prillit 2018, paragrafi 122).
43. Në këtë aspekt, GjEDNj po ashtu ka vlerësuar se, i akuzuari mund të heqë dorë nga e drejta e tij për ndihmën e një avokati. Megjithatë, përpara se për një të akuzuar të mund të konstatohet se, me sjelljen e tij, ka hequr dorë në

mënyrë të heshtur nga një e drejtë e rëndësishme që rrjedh prej nenit 6 të KEDNj-së, duhet që të vërtetohet se ai kishte mundësi të arsyeshme për t'i parashikuar pasojat e veprimeve të tij (shih rastin *Pishchalnikov kundër Rusisë*, kërkesa nr. 7025/04, Aktgjykim i 24 shtatorit 2009, paragrafi 77).

44. Në anën tjetër, përkitazi me të drejtën për ndihmë juridike falas, Gjykata vëren se GjEDNj përcakton që e drejta për ndihmë juridike falas u nënshtrohet dy kushteve (shih rastin *Quaranta kundër Zvicrës*, kërkesa nr. 12744/87, Aktgjykim i 24 majit 1991, paragrafi 27, *Caresana kundër Mbretërisë së Bashkuar*, kërkesa nr. 31541/96, Vendim për papranueshmëri, i 29 gushtit 2000) Së pari, i akuzuari duhet të provojë pamundësinë e tij financiare (shih rastin e sipërcituar *Caresana kundër Mbretërisë së Bashkuar*), dhe, së dyti, shtetet kontraktuese janë të detyruara të ofrojnë ndihmë juridike vetëm “kur këtë e kërkojnë interesat e drejtësisë”, të cilat duhet të vlerësohen duke marrë parasysh faktet e çështjes në tërësi (shih rastin e sipërcituar *Quaranta kundër Zvicrës*, kërkesa nr. 12744/87, Aktgjykim i 24 majit 1991, paragrafi 27).
45. GjEDNj, në rastet kur vendosë përkitazi me kriterin “kur interesat e drejtësisë e kërkojnë” që një të akuzuari t'i caktohet përfaqësim ligjor falas, ka përcaktuar edhe disa kritere shtesë, të cilat, ndër të tjera përfshijnë seriozitetin e veprës penale dhe ashpërsinë e dënimit në fjalë. Në parim, GjEDNj ka vlerësuar se kur privimi i lirisë është i mundur, interesat e drejtësisë kërkojnë përfaqësim ligjor (shih rastin *Benham kundër Mbretërisë së Bashkuar* [DHM], kërkesa nr. 19380/92, Aktgjykim i 10 qershorit 1996, paragrafi 61; shih rastin e cituar më lart *Quaranta kundër Zvicrës*, paragrafi 33). Si kriter tjetër i vendosur nga GjEDNj është edhe kompleksiteti i rastit (shih rastin e cituar më lart *Quaranta kundër Zvicrës*, paragrafi 34), si dhe situata personale e të akuzuarit (*Zdravko Stanev kundër Bullgarisë*, kërkesa nr. 32230/04, Aktgjykim i 6 nëntorit 2012, paragrafi 38, shih, ngjashëm Gjykata Kushtetuese, rastin KI140/18 parashtrues: *Naim Osmani*, Aktvendimi për papranueshmëri i 18 dhjetorit 2019, paragrafët 45-51).

Zbatimi i parimeve të lartpërmendura në rrethanat e rastit konkret

46. Gjykata rikujton se parashtruesi i kërkesës pretendimin të cilin fillimisht e kishte ngritur në Gjykatën e Apelit, me pas në Gjykatën Supreme, nëpërmjet kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë, e ka përsëritur edhe pranë Gjykatës Kushtetuese, thelbi i të cilit ndërlidhet me faktin se Gjykata Themelore në Mitrovicë nuk i ka caktuar atij mbrojtës (avokat) me shpenzime publike, gjatë zhvillimit të procedurës penale. Në këtë kuptim parashtruesi i kërkesës pretendon se gjykatat e rregullta shkelën të drejtën e tij për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, të garantuar me nenin 31 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 të KEDNj-së.
47. Në këtë kontekst, Gjykata fillimisht i referohet Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit, e cila përkitazi me pretendimin e mbrojtësit të parashtruesit se “aktgjykimi i ankimuar është i përfshirë me shkelje nga neni 384, paragrafi

2 të KPPRK-së, ngase i akuzuari është dashur që të këtë mbrojtës, meqë ka qenë i privuar nga liria, në kuptim të nenit 57, paragrafi 1, pika 1.2 e KPPRK-së, lidhur me nenin 248 paragrafi 2 të KPPRK-së, duke shtuar se mbrojtja në këtë çështje ka qenë e detyruar, por edhe sikur mbrojtja të mos ishte e detyrueshme, te akuzuarit është dashur t'i caktohet mbrojtësi në interes të drejtësisë ngase i njëjti fare nuk është i arsimuar dhe i takon komunitetit RAE, thekson: *"Gjykata e Apelit...vlerëson se pretendimet e mbrojtësit të të akuzuarit Teki Bokshi, se ndaj të mbrojturit të tij është shkelur e drejta në mbrojtje nuk qëndron ngase, pikë së pari vepra penale për të cilën ka qenë i akuzuar i mbrojturi i tij nuk është veprë penale që parasheh mbrojtje të detyrueshme e po ashtu i mbrojturi i tij nuk ka qenë në paraburgim për këtë veprë penale për të cilën edhe është gjykuar, porse i njëjti ka qenë në vuajtje të dënimit për një veprë tjetër penale, e po ashtu nga procesverbali i shqyrtimit fillestar i datës 06.01.2020, konstatohet se i mbrojturi i tij është udhëzuar drejtë nga ana e gjykatës së shkallës së parë me të drejtat e tij, mes tjerash edhe me të drejtën e tij të angazhimit të mbrojtësit, mirëpo është deklaruar se mbrojtjen do ta japë vet, andaj në këtë drejtim kolegji penal i kësaj gjykate pretendimet e mbrojtësit të të akuzuarit i refuzoj si të pabazuara".*

48. Gjykata gjithashtu u referohet pjesëve relevante të Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, e cila përkitazi me pretendimin e ngritur nga parashtruesi i kërkesës për të drejtën në mbrojtje, arsyetoi: *"Është e rëndësishme të theksohet fakti se në rastin konkret i dënuari në të gjitha fazat e procedurës penale është njoftuar për veprën penale dhe të drejtën e tij për të pasur mbrojtës dhe atë që nga hetimet e zhvilluara nga ana e prokurorit të shtetit dhe po ashtu edhe gjatë shqyrtimit fillestar përkatësisht nga faqja e dytë të procesverbalit të datës 06.11.2019 del se i dënuari është njoftuar për të drejtën në mbrojtës, dhe për më tepër, ky njoftim është lehtë i kuptueshëm edhe përkundër faktit se i dënuari ishte person i paarsimuar. Mirëpo përkundër faktit se kishte deklaruar se ka kuptuar të drejtën për të pasur mbrojtës nuk e ka parë të nevojshëm angazhimin e tij".*
49. Tutje, Gjykata vëren se përkitazi me të drejtën për mbrojtje të detyruar Gjykata Supreme, arsyetoi: *"...bazuar në kualifikimin ligjor të veprës penale në rastin konkret del se nuk janë plotësuar kushtet për sigurimin e mbrojtjes së detyruar, siç është përcaktuar me dispozitën e nenit 57 të KPPK-së, meqë i njëjti ishte në vuajtje të dënimit për veprë tjetër penale dhe jo për veprën penale për të cilën ishte duke u zhvilluar procedura penale".*
50. Gjykata po ashtu rikujton vlerësimin e Gjykatës Supreme, e cila kishte shqyrtuar edhe çështjen e mbrojtjes së detyruar me shpenzime publike, duke arsyetuar: *"Për më tepër, i dënuari nuk kishte paraqitur kërkesë për mbrojtës me shpenzime publike, siç është përcaktuar me dispozitën e nenit 58 të KPPK-së, dhe nga kjo del se nuk qëndrojnë pretendimet e theksuara se në rastin konkret janë cenuar të drejtat e të dënuarit gjatë zhvillimit të procedurës penale, meqë ndaj tij është zhvilluar një proces gjyqësor i rregullt dhe në asnjë rrethane nuk janë cenuar të drejtat e të dënuarit të garantuara me dispozitat e procedurës penale dhe instrumentet ndërkombëtare për të cilat pretendohet në kërkesë".*

51. Prandaj, nga shtjellimet e mësipërme, bazuar dhe në parimet e përgjithshme të vendosura në praktikën e GjEDNj-së përkitazi me të drejtën për t'u mbrojtur vetë dhe vlerësimin e Gjykatës Supreme, të cilin vlerësim e ka bazuar në rrethanat e rastit konkret dhe dispozitat përkatëse të procedurës penale, Gjykata vlerëson se pretendimet e parashtruesit të kërkesës për shkelje të së drejtës së tij në mbrojtje, të garantuar me nenet 30 dhe 31 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 të KEDNj-së janë qartazi të pabazuara.
52. Në këtë kontekst, Gjykata vëren se kriteret kryesore përkitazi me të drejtën në përfaqësim ligjor falas, të përcaktuara në praktikën gjyqësore të GjEDNj-së dhe të mishëruara edhe në dispozitat e KPPRK-së, përkatësisht kriteri i pamundësisë financiare dhe "*kur interesat e drejtësisë e kërkojnë*" angazhimin e mbrojtësit me shpenzime publike janë shqyrtuar edhe vlerësuar edhe nga Gjykata Supreme. Përveç kësaj, Gjykata Supreme, gjithashtu e ka vlerësuar edhe kriterin shtesë përkitazi me lartësinë e dënimit të paraparë në procedurën penale, e që në rastin e parashtruesit të kërkesës dënimi i paraparë në procedurën penale të zhvilluar kundër tij është më pak se 8 (tetë) vjet.
53. Si rrjedhojë, Gjykata, duke marrë për bazë pretendimet e parashtruesit të kërkesës dhe faktet e paraqitura nga ai, dhe bazuar në parimet e përgjithshme të vendosura në praktikën e GjEDNj-së, e cila ka theksuar se e drejta për të pasur mbrojtës nuk është absolute dhe se kjo e drejtë duhet të interpretohet në pajtim me legjislacionin përkatës në fuqi dhe rrethanat konkrete të rastit, vlerëson se interpretimi dhe arsyetimi i Gjykatës Supreme është i bazuar në ligj dhe i mbështetur në faktet e paraqitura para kësaj Gjykate.
54. Prandaj, Gjykata gjen se pretendimet e parashtruesit të kërkesës për cenimin e të drejtës së tij në mbrojtës, e cila është element përbërës i së drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm të garantuar me nenet 30 dhe 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNj-së janë qartazi të pabazuara.

Përfundim

55. Si përfundim, dhe duke u bazuar në elaborimin e mësipërm, Gjykata konsideron se parashtruesi i kërkesës nuk i ka mbështetur pretendimet se procedurat përkatëse të ndjekura nga gjykatat e rregullta në ndonjë mënyrë ishin të padrejta apo arbitrare, dhe se me Aktgjykimin e kontestuar janë shkelur të drejtat dhe liritë e garantuara me Kushtetutë dhe me KEDNj (shih, *mutatis mutandis*, *Shub kundër Lituanisë*, nr. 17064/06, GjEDNj, Vendimi i 30 qershorit 2009, si dhe në rrethana të ngjashme rastin KI140/18, me parashtrues *Naim Osmani*, Aktvendimi për papranueshmëri i 18 dhjetorit 2019).
56. Prandaj, Gjykata konstaton se kërkesa e parashtruesit të kërkesës nuk i përmbushë kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara me Rregulloren e punës, sepse kërkesa është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese, duke marrë parasysh që faktet e paraqitura në asnjë mënyrë nuk e arsyetojnë pretendimin për shkeljen e një të drejte kushtetuese dhe që parashtruesi i

kërkesës nuk e dëshmon mjaftueshëm pretendimin e tij për shkelje kushtetuese.

57. Rrjedhimisht, Gjykata vjen në përfundim se kërkesa është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese dhe duhet të deklarohet e papranueshme, në pajtim me rregullin 39 (2) të Rregullores së punës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, në nenin 20 të Ligjit dhe në pajtim me rregullin 39 (2) të Rregullores së punës, më 29 korrik 2021, njëzëri

VENDOS

- I. TË DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- III. TË PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues



Nexhmi Rexhepi

Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese



Gresa Caka-Nimani